- 218.** Më 12 korrik 2017, filloi Projekti EU/UNDP: “Përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura”.
- 219.** Filloi realizimi i fazës së dytë të Programit të ruajtjes së natyrës në Maqedoni, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).
- 220.** Në nëntor 2017 u përfundua projekti Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në Prespë, Ohër dhe Liqenin e Shkodrës (CSBL).
- 221.** Negociatat për nënshkrimin e një memorandumit bashkëpunimi për iniciativën për krijimin e Fondit Natyrës Prespa-Ohër (PONT).
- 222.** Në pjesën e valorizimit të trashëgimisë natyrore, vazhdoi studimi për valorizimin e vlerave natyrore të Malit Sharr, si dhe raritetet e tjera natyrore;
- 223.** Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ratifikoi Traktatin e Parisit në nëntor të vitit 2017 duke konfirmuar angazhimin e saj për t’u bashkuar me përpjekjet globale për të reduktuar ndryshimet klimatike, Kuvendi gjithashtu miratoi Raportin e dytë bional të ndryshimeve klimatike që përmban të dhënat e fundit dhe analizat e emetimeve dhe (depërtimin) absorbimin e gazrave serrë GHG;
- 224.** Gjatë dhjetë muajve të fundit është miratuar dokumentacioni i përgjithshëm për 7 nga 8 rajonet e planifikuara në Republikën e Maqedonisë për krijimin e një sistemi të integruar rajonal për menaxhimin e mbeturinave dhe është arritur një marrëveshje politike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe vetëqeverisjes lokale për krijimin e sistemit të lartpërmendur;
- 225.** U formua grupi i punës brenda sektorit për ajër, është siguruar mjet për mirëmbajtjen e stacioneve të monitorimit dhe një stacioni mobil për cilësinë e ajrit të ambientit;
- 226.** Filloi projekti i financuar nga Qeveria zvicerane, i zbatuar nga UNDP për “Zvogëlimin e rrezikut të përmytjeve në rajonin e Pollogut”. Projekti zbatohet në katër vitet e ardhshme (nga nëntori 2017 deri në dhjetor 2021);
- 227.** Ndërtimi i një pjese të sistemit të furnizimit me ujë për Komunën e Likovës në vlerë prej 138 milion denarë, të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- 228.** Ndërtimi i një pjese të kanalizimit fekal për Komunën e Haraçinës në vlerë prej 35 milionë denarë, të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë.
- 229.** Ndërtimi i kolektorit kryesor fekal dhe sekondar në Komunën e Koçanit në vlerë prej 90 milionë denarë, të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, si dhe ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura të financuara nga Qeveria zvicerane në vlerë prej 1 miliardë denarë;

- 230.** Në mars të vitit 2018 u vu në përdorim një impiant për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Kërçovës, për 48.000 banorë ekuivalent dhe 4.7 km kolektor për pastrimin e ujërave të zeza në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza. Vlera e përgjithshme e projektit është 8.254.355 euro;
- 231.** Më 18 dhjetor 2017 u vu në përdorim impianti për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në Strumicë, me kapacitet prej 53.000 banorësh ekuivalent. Vlera e përgjithshme e projektit është 6.910.876 euro;
- 232.** Në dhjetor të vitit 2017 përfundoi projekti Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Berovës. Vlera e përgjithshme e projektit është 3.863.186 euro;
- 233.** Në dhjetor të vitit 2017 përfundoi projekti Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Kumanovë. Vlera totale e projektit 4.323.224,55 euro;
- 234.** Në shkurt të vitit 2018 filloi realizimi i projektit "Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në qytetin e Shkupit". Projekti është me vlerë prej afër 10 milionë euro;
- 235.** Rritëm fondet vjetore për zhvillim të barabartë rajonal prej 4 deri më 80 milionë euro, me mekanizma transparente për shpërndarje të barabartë të fondeve prej 1% të PBB-së (në regjione të planifikimit dhe komuna), që ka për qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe zvogëlimin e dallimeve rajonale;
- 236.** Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018 fondet për zhvillim të barabartë rajonal janë me vlerë prej 328.873.000 denarë, që është një rritje prej 101 milion denarë në krahasim me vitin 2017, kur për këtë qëllim janë ndarë 227.691.000 denarë;
- 237.** Zbatojmë projektin "Zhvillim rajonal të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës", në bashkëpunim me Qeverinë e Zvicrës, që për këtë projekt jep donacion prej 2.539.997 CHF për periudhën 2017-2020, ndërsa nga buxheti i Ministrisë së Vetëqeverisje Lokale për bashkëfinansim janë ndarë mjete në vlerë 1.269.440 CHF;
- 238.** Filluam me zbatimin e projektit: "Përmirësimi i menaxhimit komunal", financuar nga Bashkimi Evropian me vlerë prej 2,3 milionë euro (Projekti zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP));
- 239.** Jemi duke përgatitur ndryshim dhe plotësim të Programit për zhvillim të qëndrueshëm dhe decentralizim 2015-2020, si dhe njëplan të ri të veprimit për periudhën 2018-2020;
- 240.** Grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të ministrive përkatëse dhe BNjVL po punon në përcaktimin e mënyrës dhe kritereve për ndarjen e granteve

dhe bllok-dotacioneve për komunitat me qëllim që të sigurojnë shpërndarjen transparente të fondeve të dedikuara për funksionimin e shkollave filllore dhe të mesme, kopshteve për fëmijë, institucioneve publike për kujdesin e të moshuarve dhe institucioneve vendore në fushën e kulturës.

- 241.** Organizojmë pushim për 3000 familje të punëtorëve me të ardhura të ulëta, të ardhurat e të cilave nuk i kalojnë 22 mijë denarë në një familje, me anë të subvencioneve prej 15 mijë denarëve, për shfrytëzimin e pushimeve jashtë sezonit në një nga objektet e hotelerisë në Republikën e Maqedonisë.
- 242.** Kemi përgjysmuar borxhet e trashëguara nëpër konviktet e nxënësve dhe studentëve;
- 243.** U hartua dhe miratua Ligji i ri për arsimin e lartë, i cili rikthen autonominë e universiteteve dhe është një parakusht për ngritjen e cilësisë së arsimit, dhe njëkohësisht përgatiten ndryshime të Ligjeve për arsimin fillor dhe të mesëm;
- 244.** U hartua Ligji mbi gjimnazin, drejtimi matematikë dhe informatikë, i cili do të mundësoj krijimin dhe funksionimin e gjimnazit të parë të këtij lloji për studentët e talentuar;
- 245.** Filluam me rishikimin e sistemit arsimor dhe kurrikulave dhe planeve për arsimin fillor nga klasa e parë deri në të tretën;
- 246.** Filluam me rishikimin e teksteve shkollore në arsimin fillor, që ka për qëllim të sigurojë tekste shkollore më cilësore për nxënësit, pa diskriminim, paragjykime dhe gabime;
- 247.** Filluam reformat në arsimin e mesëm profesional, në drejtim të harmonizimit të stafit profesional që del nga shkollat me nevojat e tregut të punës, si dhe përmirësimin e kushteve për mësim dhe cilësinë në arsimin profesional.
- 248.** Hartuam Strategjinë e Re të Arsimit 2018-2025, e cila bazohet në identifikimin e sfidave kryesore në arsim dhe përcaktimin e prioriteteve për të cilat Qeveria do të fokusohet në periudhën që vijon;
- 249.** Rishikuam listën e lektyrave për arsimin fillor, për të cilën është dorëzuar propozim dhe në vazhdimisht të debati publik;
- 250.** Me zvogëlimin e çmimeve të barnave me recetë për 50 përqind, duke filluar nga kjo pranverë do të kursehen 2.381.600 euro, para të qytetarëve.
- 251.** Parashikimet për zhvillim ekonomik, konsolidimi i të hyrave buxhetore, do të na mundësojnë realizimin e masës për lirin nga participimi për shërim spitalor për të gjithë qytetarët;

- 252.** U formua Komiteti i ri për imunizim në përbërje të zgjeruar, dhe për së pari herë siguroam vaksina kundër gripit sezonal dhe vaksinim pa pagesë për personat e moshuar;
- 253.** Në Programin për shëndet publik për vitin 2018 janë paraparë kontrollime preventive nga fizioterapeutët për diagnostikim të hershëm të deformimeve të shtyllës kurrizore te fëmijët e moshës shkollore;
- 254.** Duke filluar nga viti 2018, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Shëndetësisë morën për obligim financimin e plotë të Programit Kombëtar HIV, që deri më tani është bashkëfinancuar nga Fondi Global.
- 255.** Modernizimi i kalendarit të imunizimit me ndryshimin e dy vaksinave ekzistuese dhe vënien e vaksinimit kundër pneumonisë streptokokus dhe vaksinimin kundër viruseve Rota, si vaksina të detyrueshme, duke mbrojtur fëmijët nga sëmundjet e rënda dhe komplikime që mund të shkaktohen nga këto shkaktues;
- 256.** Miratuar Protokollin për shërimin e fëmijëve të varur nga substancat psikoaktive;
- 257.** Në procedurë e sipër është krijuar një Trupi koordinues nacional (Shtabi i krizave) që ka për detyrë të bëjë koordinimin, të propozojë masa dhe të ndjek zbatimin e tyre, gjatë situatave emergjente dhe katastrofave në sferën e shëndetësisë.
- 258.** Me ndryshimin e Ligjit për studimet mjekësore dhe edukimin e vazhdueshëm mjekësor, shfuqizuar detyrimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të përgatitur një plan vjetor për edukimin e 1000 personave jashtë vendit, tani ky obligim është i institucioneve publike shëndetësore sipas nevojave të tyre;
- 259.** U realizua shpallja e tretë për bashkëfinancim të specializimeve dhe ka filluar realizimi i 12 specializimeve për gjinekologji dhe akusher, me qëllim që të sigurohen gjinekologë në vendet ku janë deficitarë;
- 260.** U formua Komisioni i ri për sëmundjet e rralla ku u përfshinë ekspert nga të gjitha Klinikat universitare ku kurohen pacientë me sëmundje të rralla dhe në procedurë e sipër është procedura për furnizimin publik të të gjithë ilaçeve të nevojshme për sëmundjet e rralla, ku janë siguruar 400.000.000 denarë;
- 261.** Ministria e Shëndetësisë vendosi për zvogëlimin e numrit të drejtorëve, ku në nivel vjetor vetëm për paga të drejtorëve organizativ në 40 institucione shëndetësore pritet që dukshëm të ulen shpenzimet e përgjithshme;
- 262.** Në buxhetin e shëndetësisë për vitin 2018 janë siguruar gjithsej 221.000.000 denarë për furnizim të pajisjeve mjekësore për nevojat e IPSh ;

- 263.** Siguroam sallë hibride në të cilën do të zbatohet kombinim i kirurgjisë endoskopike dhe të hapur dhe e kundërta;
- 264.** Në buxhetin e vitit 2018, me mamografi furnizua IPSh Shtëpinë e Shëndetit-Shkup, Spitalin e Përgjithshëm Kumanovë, Shtëpinë e Shëndetit Kriva Pallankë dhe Spitalin Klinik në Manastir;
- 265.** U nënshkrua memorandumi ndërmjet Qeverisë së Maqedonisë dhe Bullgarisë për të ulur tarifën ndërkombëtare për roaming në shërbimet e telekomunikacionit;
- 266.** U pranuan 125 ushtarë të rinj profesionistë në ARM;
- 267.** Nëpërmjet një procesi të gjerë konsultativ, zhvilluam Strategji për zhvillimin kulturor për 5 vitet e ardhshme (2018-2022) dhe një Plan veprimi (2018-2022), të cilat u miratuan nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
- 268.** Hartuam ndryshime ligjore me të cilat zgjidhim çështjet e rëndësishme dhe sistematikisht përkujdesemi për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e kulturës dhe artit në afat më të gjatë;
- 269.** Nëpërmjet konkursit për “Valën e re kulturore”, arritëm të motivojmë organizimin e më shumë se 100 ngjarjeve kulturore dhe artistike në vend dhe të gjallërojmë skenën kulturore të pavarur;
- 270.** I hapëm dyert e institucioneve kulturore dhe Ministrisë së Kulturës për bashkëpunim me sektorin civil dhe skenën kulturore të pavarur;
- 271.** Arritëm sukses të madh në skenën ndërkombëtare kulturore - hapëm Qendrën për Bashkëpunim Kulturor të Iniciativës “16 + 1” për bashkëpunim midis vendeve të Evropës Juglindore dhe Republikës Popullore të Kinës;
- 272.** Realizua ndërhyrje emergjente në Çifte Hamam, në Hamamin e Daut Pashës dhe në Muzeun e Maqedonisë për mbrojtjen e trashëgimisë së çmuar kulturore të lënë pas dore nga shirat e rrëmbyeshëm;
- 273.** Nisëm proces për mbrojtjen e afreskeve të Strumicës “Shën Pesëmbëdhjetë Martirët e Tiberiopolis”, një nga më të lashtat në rajonin tonë, për vite e lënë në mëshirën e fatit dhe kushteve klimatike;
- 274.** Filluam aktivitete intensive për mbrojtjen e kishës “Shën Gjergji” në Kurbinovë;
- 275.** Në vitin 2018, bëjmë kontrollin dhe fshirjen nga regjistri për të gjitha monumentet dhe objektet ilegalisht të regjistruara nga i ashtuquajtimi projekti “Shkupi 2014”, të cilat sipas natyrës së tyre nuk mund të përfaqësojnë trashëgimi kulturore;

- 276.** U formua Komisioni për menaxhim me trashëgiminë kulturore dhe natyrore botërore në rajonin e Ohrit, i përbërë nga 22 institucione dhe organe shtetërore në nivel qendror dhe lokal, komisioni i cili për 8 vite nuk është formuar, edhe pse ligji e parasheh atë; Komisioni veçmë ka mbajtur dy mbledhje dhe ka filluar me realizimin e masave që deri në fund të vitit duhet ta përmirësojnë gjendjen dhe të kontribuojnë për vlerësim pozitiv të mundit tonë në organizatën botërore.
- 277.** Qeveria miratoi një vendim me pako prej 11 masave për avancimin e gjuhës maqedonase;
- 278.** U hartuan dhe miratuan ndryshimet në Ligjin për përdorimin e gjuhës maqedonase;
- 279.** U zgjodh Komisioni për zbatimin e provimit për lektor, si dhe veprime të tjera me të cilat u zhblllokua procesi i kalimit të provimit për lektor;
- 280.** Mundësuaam kushte më të mira për mbrojtjen dhe avancimin e gjuhës maqedonase në komunikimin publik
- 281.** Fillojmë me reforma prej në themel dhe me avancimin e të drejtave të artistëve dhe punëtorëve kulturorë përmes hartimit të marrëveshjes kolektive për punonjësit në kulturë;
- 282.** E reformojmë sistemin e financimit të Institucioneve Kombëtare, për të fituar buxhet të rezervuar, në bazë të planit strategjik për periudhë prej tre vitesh;
- 283.** Janë zbatuar procedura për tenderë në më shumë institucione kombëtare, fillon rikonstruimi i kulmeve në disa teatro dhe qendra kulturore në vend;
- 284.** Raportet e elaboratit të grupit punues të Ministrisë së Kulturës për përmendoren e A.J.Qose janë zbatuar nga autoritetet përkatëse dhe përmendorja e paligjshme është larguar;
- 285.** Janë përgatitur më shumë elabore për objekte dhe përmendore nga i ashtuquajturit Projekti “Shkupi 2014”;
- 286.** Zbatuam debat publik për iniciativën e revitalizimit të produksionit muzikor të RTM-së, e cila është pranuar me aklamacion nga të gjithë punonjësit e muzikës në vend. Qeveria miratoi konkluzionin me të cilin detyron ministrinë dhe institucionet kompetente të vazhdojnë me zbatimin e këtij procesi;
- 287.** Me shlyerjen e borxheve në kohë për ndërtimin e Filarmonisë së Maqedonisë, parandaluam dënime interesi prej qindra mijëra euro dhe fituam donacion të vlefshëm - piano të cilësisë së lartë “Steinway” me vlerë prej 170 mijë euro nga kompania Shtrabag;

- 288.** Ndhmuam në tejkalimin e situatës me mungesë të hapësirës dhe mjetevedhe këtë vit arritëm pa asnjë pengesë të mbahet edicioni i 30-të jubilarit Panairit të Librit, me vizita falas për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme;
- 289.** Disa institucione shkencore dhe kulturore realizuan projekte për digjitalizimin e krijimtarisë sonë muzikore dhe letrare;
- 290.** Me Qytetin e Shkupit u nënshkrua letër për qëllime të rikonstruksionit të Sallës Universale, fillojnë përgatitjet e dokumentacionit, ndërsa ndërtimi do të fillojë në vitin 2019;
- 291.** Promovuam zbulimin e rëndësishëm paleontologjik - mbetjet fosile të specieve të zhdukura të elefantit në Dollni Disan, i cili ishte në fokusin e disa mediave të rëndësishme globale (Daily Mail, Chicago Tribune, Business Insideretj.);
- 292.** Me Institucionin Ndëshkues-Korrigjues “Burgu Shkup” nënshkruam memorandum bashkëpunimi, me të cilin adresohen të gjitha rekomandimet e CPT-së të Këshillit të Evropës dhe planifikohen aktivitete për të avancuar përmbajtjet kulturore dhe artistike të të burgosurve, si një nga grupet më të rrezikuara të qytetarëve;
- 293.** Maqedonia u bë anëtare formale e “TRADUKI”. Në takimin e parë të rrjetit ku marrim pjesë si anëtare e plotë u siguruan fonde për më shumë projekte të reja të botuesve maqedonas;
- 294.** Në Davos u nënshkrua Deklarata për Baukulturë - kulturë e ndërtimit;
- 295.** U arrit marrëveshje për prani domethënëse të artistëve maqedonas në Plovdiv vitin e ardhshëm, qyteti i cili do të jetë kryeqyteti kulturor i Evropës për vitin 2019;
- 296.** Maqedonia ka projekt të shkëlqyeshëm në Bienalen e Arkitekturës në Venedik, me vizione për ballafaqim me trashëgiminë nga “Shkupi 2014”;

**MAQEDONIA -
NJË SHOQËRI
DHE NJË FAMILJE
PËR TË GJITHË.**

NJË VIT  NDRYSHIME

MAQEDONIA PËR TË GJITHË

MAQEDONIA - NJË SHOQËRI DHE NJË FAMILJE PËR TË GJITHË, TË GJITHË JANË QYTETARË TË RENDIT TË PARË

- 297.** Me politikën “Një shoqëri” i zvogëluam ndasitë dhe e rritëm besimin mes komuniteteve;
- 298.** Realizuam seancë tematike qeveritare kushtuar politikave rinore, në të cilën në propozim të organizatave rinore u formuan disa grupe punuese, edhe atë: Grupi punues për njohjen e punës rinore, grupi punues për definimin e ko-menaxhment trupit për koordinim mes organizatave rinore dhe institucioneve për dialog strukturor, grupi punues për arsim gjithëpërfshirës seksual, grupi punues për organizim demokratik në shkollat e mesme, grupi punues për organizim demokratik studentor, grupi punues për hartimin e vendeve të gjelbërta të punës dhe lidhja e tyre me papunësinë në vend, dhe grupi punues për përpilimin e programit për kujdes gjithëpërfshirës dhe mjekim për shrytëzuesit e rinj të supstancave psikoaktive.
- 299.** E përmirësuam klimën për bashkëpunim dhe inkuadrim të shoqërisë civile si partner në demokratizimin e shoqërisë;
- 300.** E sollëm Ligjin për përdorimin e gjuhëve, me të cilin do të zgjerohet përdorimi i gjuhës zyrtare të cilin e flasin së paku 20% e qytetarëve, sipas Kushtetutës dhe Amendamentit V, dhe rritëm mundësitë që qytetarët me institucionet të komunikojnë në gjuhën amtare dhe kështu më lehtë dhe me efikasitet të realizojnë të drejtat e tyre kushtetuese;
- 301.** Ligji për përdorimin e gjuhëve plotësisht garanton edhe përdorimin e përshtatshëm të gjuhës maqedonase dhe gjuhëve të tjera në përdorim zyrtar në disa njësi të qeverisjes lokale (shqipe, turke, rome, serbe, vllehe dhe boshnjake);
- 302.** Ndërmorëm një sërë masash për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Republikës së Maqedonisë dhe për mbrojtjen dhe avancimin e gjuhës maqedonase;
- 303.** Botuam versionin elektronik të “Drejtshkrimit të Gjuhës Maqedonase”, falas, për herë të parë në dispozicion për të gjithë;
- 304.** Fondi i gjuhës maqedonase do të mbështesë hapjen dhe përkrahjen e lektorëve të gjuhës maqedonase në universitetete të huaja në BE, posaçërisht

në vendet themeluese të BE-së si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, Australi dhe në Federatën Ruse;

- 305.** Mundësuam që Seminari i gjuhës, letërsisë dhe kulturës maqedonase të shndërrohet në Qendër Maqedonase “Makedonikum”, nëpërmjet të cilit do të sigurohen bursa për një numër më të madh të të huajve që do të vijnë të mësojnë gjuhën, letërsinë dhe kulturën maqedonase;
- 306.** Masat për avancimin e situatës me gjuhën maqedonase parashikojnë edhe themelimin e Fondit për mbështetjen e veprimtarisë botuese për ribotim dhe botime të reja të punimeve shkencore dedikuar gjuhës maqedonase në të gjitha fushat;
- 307.** Masat duhet të rezultojnë me themelimin e fondit për ndarjen e bursave për studime në gjuhën maqedonase në universitetet e Republikës së Maqedonisë dhe rishikimin e planeve dhe programeve arsimore në gjuhën maqedonase në të gjitha nivelet e arsimit;
- 308.** Shmangëm rrezikun të humbet statusi i trashëgimisë botërore i UNESCO-së në rajonin e Ohrit;
- 309.** E mbrojtëm galerinë e ikonave në Muzeun e Maqedonisë;
- 310.** Ndërmorëm veprime për mbrojtjen dhe ruajtjen e plotë të Akueduktit të Shkupit dhe krijimin e një ambienti më të mirë me disa përmbajtje shoqëruese rekreative dhe kulturore;
- 311.** Me rastin e shënimit të 109 vjetorit të Alfabetit shqiptar në Manastir u mbajtën aktivitete të ndryshme (Ceremonia e hapjes së kolonisë së artit, hapja e Tribunës shkencore dhe Gala koncert);
- 312.** Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi informacionin për themelimin e Ansambllit Shtetëror Shqiptar;
- 313.** Plani për shpërndarjen e 958 nga 1600 punonjës administrativ të punësuar në SIMO u miratua në Qeveri;
- 314.** U ndërpre nevoja e raportit konsultativ nga më së paku 3 mjekë për realizimin e së drejtës për kompensim financiar për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër;
- 315.** E drejta për kompensim financiar për ndihmë dhe përkujdesje nga një person tjetër, mjetet shtesë për mobilitet (lëvizshmëri), verbëri dhe shurdhim realizohen pavarësisht shumës së të ardhurave të personit në nevojë;
- 316.** Kompensimi për orar të shkurtuar pune për prindërit e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara garantohet pavarësisht nga mosha e personit;

- 317.** E drejta për pagesë shtesë deri në 26 vjeç transferohet automatikisht në të drejtë për ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër;
- 318.** Me ndryshimet legislative u mundësua orari i punës me orar të shkurtuar për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të vazhdojë edhe pas moshës 26 vjeç;
- 319.** Për herë të parë u miratua Programi për asistencë personale të personave me nevoja të posaçme, krejtësisht të financuara nga Buxheti;
- 320.** Sollëm Programin për lirim nga participimi shëndetësor për fëmijët nga familjet shfrytëzues të asistencës sociale;
- 321.** Përkrahëm themelimin e Qendrës ditore për persona me Sindromën Daun;
- 322.** U formua ekipi i specializuar për veprimin e lëndëve emergjente nga kategoritë e rrezikuara në IP Qendrën ndërkomunale për punë sociale në Qytetin e Shkupit;
- 323.** Zgjidhëm problemin me rreth 3000 persona të paevidentuar në Regjistrin e lindjes;
- 324.** Hartojmë Strategjinë nacionale për bashkëpunim me diasporën;
- 325.** Hapim zyra për bashkëpunim me Diasporën në komunat e Republikës së Maqedonisë. Zyra e parë hapet në Komunën Shtip;

**HAPËROJMË DREJT
NATO-s dhe BE-së,
ZGJIDHIM
KONTESTE
DHE FUQIZOJMË
IDENTITETIN.**

NJË VIT  NDRYSHIME

MAQEDONIA PËR TË GJITHË

HAPËROJMË DREJT NATO-s dhe BE-së, ZGJIDHIM KONTESTE DHE FUQIZOJMË IDENTITETIN

- 326.** Qeveria e Republikës së Maqedonisë vazhdon bisedimet me Qeverinë e Republikës së Greqisë që përfundimisht të zgjidhet kontesti 25 vjeçar;
- 327.** Asnjëherë nuk kemi qenë më afër zgjidhjes, ndërsa miqësia ndërmjet dy vendeve kurrë nuk ka qenë më e madhe;
- 328.** Gjuha maqedonase është konfirmuar. Identiteti ynë maqedonas është përforcuar;
- 329.** Fjalën e fundit për konfirmim të propozim zgjidhjes qytetarët do ta thonë në referendum;
- 330.** Maqedonia pas zgjidhjes së kontestit me emrin, menjëherë do të bëhet anëtare e NATO-s dhe me këtë akoma më shpejtë dhe me më shumë vendosmëri do t'i hap dyert e BE-së dhe do të sigurohet jetë e mirë dhe e qëndrueshme për popullin tonë;
- 331.** Siguroam 15% më shumë buxhet për mbrojtje për një armatë bashkëkohore dhe të motivuar;
- 332.** Me Strategjinë e re për zgjerim, Komisioni Evropian konfirmoi ardhmërinë evropiane të Republikës së Maqedonisë si pjesë të strukturës politike të Bashkimit Evropian dhe i rekomandoi Këshillit të Evropës të përcaktojë datën për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE;
- 333.** Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Miqësisë me Bullgarinë, tregtia mes dy vendeve u rrit për 11,5%;
- 334.** Realizuar vizitatë shumta pune jashtë shtetit nga përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
- 335.** Takimi i ministres Shekerinska me sekretarin amerikan të mbrojtjes Matis. Pas 6 vitesh ky është takimi parë i një ministri të mbrojtjes me një koleg amerikan;
- 336.** Shqyrtimistrategjik i mbrojtës është në fazën finale, në përputhje me standardet e NATO-s. Ky është dokumenti i parë strategjik i mbrojtës pas vitit 2004;
- 337.** Në maj u realizuan konsultimet bilaterale me NATO-n dhe është aprovuar pako e re e Qëllimeve tëPartneritetit (QP)2018 për RM-në;

- 338.** Ndërmorëm masa për zbatimin sistematik dhe sistemor të gjendjeve të hasura në MPJ, nëpërmjet vendosjes së sistemit me të cilin parimisht do të tejkalohen parregullsitë në të gjitha fushat e funksionimit;
- 339.** U hartua analizë funksionale në MPJ ku me ndihmën e ekspertëve të huaj punohet në reformat, si projekt pilot që realizohet në kuadër të projektit për reforma në MShIA-së;
- 340.** Organizuam dhe zbatuam trajnime për arritje dhe njohuri më të mëdha diplomatike (për titujt e sekretarisë);
- 341.** Zbatuam procedurë të rregullt për përzgjedhjen e diplomatëve për plotësimin e 24 vendeve në PDK(16 për tituj të lartë dhe 8 për tituj diplomatik të sekretarisë);
- 342.** Formuam disa komisione për vërtetimin e gjendjes faktike dhe keqpërdorimeve eventuale në më shumë fusha të punës së MPJ-së dhe PDK-së;
- 343.** Siguroam grant nga Mbretëria Norvegjeze për projekt për përpunimin e sistemit për procesimin e informacioneve të klasifikuara në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
- 344.** Ministria e Punëve të Jashtme projektoi dhe siguroi buxhetin për vitin 2018 për sanimin e objekteve të ambasadave në Berlin dhe Romë, në procedurë e sipër është hartimi i dokumentit projektues për ndërtimin e objektit në Athinë;
- 345.** Me përkrahjen e fondeve të BE-së u nënshkrua Marrëveshja nga DBE dhe 2 IPA projekte nga fushat “Mbrojtja konsumatorëve” dhe “Mbikqyrja e tregut”;
- 346.** U nënshkrua Marrëveshje nga DBE-ja për projektin “Përkrahje teknike për zhvillimin e politikave për mbrojtje të konsumatorëve”, ku shfrytëzuesi final është Ministria e Ekonomisë (Sektori i tregut) me përkrahje të Fondit të IPA-s;
- 347.** U nënshkrua Marrëveshje me Drejtorinë për Zgjerim të BE-së për projektin “Harmonizimi i kornizës ligjore dhe ndërtimi i kapaciteteve për mbikqyrjen e tregut, lidhur me Kapitullin I”;
- 348.** Në fushën e turizmit, u realizua projekti i IPA-s me qasshmëri të centralizuar dhe kryesohet nga Banka Botërore, ku Ministria e Ekonomisë nëpërmjet Sektorit për integrim evropian dhe Sektorit për turizëm janë iniciatorë për këtë projekt;
- 349.** Fondet IPA të BE-së mundësuan nënshkrimin e 4 marrëveshjeve (projekte për zhvillimin e turizmit) edhe atë në Komunën e Vevçanit, Komunën e Çairit, Komunën e Bosilevës dhe Komunën e Krueshevës nga shpallja e parë;

- 350.** Më 16.03.2018 u shpall thirrja e dytë për aplikim për komuna tjera të interesuara dhe për sektorin privat, në vlerë prej 14 milion euro në formë granti nga fondet e IPA-s;
- 351.** Filluan përgatitjet për kalimin e fazës së dytë të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA), nëpërmjet informimit të Qeverisë dhe ministrive përkatëse rreth momenteve të reja, mundësive dhe obligimeve që do të dalin me kalimin e fazës së dytë të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim;
- 352.** U hartua master plan i posaçëm i IPA-s, qëllimi i të cilit është monitorim dhe koordinim i përforcuar i aktiviteteve për avancimin e shfrytëzimit të mjeteve nga IPA;
- 353.** SÇE bëri analizë dhe dha rekomandime që kryesimi i grupeve të punës të sektorëve të bëhet nga ministrat e ministrive kompetente. Në periudhën shkurt-maj 2018, ministrat e morën këtë funksion dhe janë organizuar nga dy takime në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, arsimin, punësimit dhe politikës sociale dhe në konkurrencë dhe inovacione, për shkak të programimit vijues të afër 50 milion eurove për vitin 2019;
- 354.** Në periudhën e kaluar u mbajtën takime të Komitetit tëPërbashkët për Monitorim dhe tre takime të komiteteve sektoriale për monitorim për drejtësi, punë të brendshme dhe konkurrencë, inovacione, bujqësi, siguri të ushqimit, veterinari dhe politikëfitosanitare si dhe IPARD. Rëndësia e këtyre forumeve buron nga përcjellja e efikasitetit dhe efektivitetit në shfrytëzimin e ndihmës së BE-së;
- 355.** Nëpërmjet Instrumentit për kornizën finale për Ballkanin Perëndimor në vitin e kaluar, u fitua grant si ndihmë me vlerë prej 71,3 milion euro për ndërtimin e fazës së dytë të ndërtimit të hekurudhës drejt Bullgarisë dhe për hartimin e dokumentacionit teknik për lidhjen me autostradëtë aksit rrugor Shkup-Bllacë;
- 356.** Pas 6 vitesh mungesë, Suedia u rikthye si donator bilateral në Republikën e Maqedonisë me ndarjen e mjeteve për zhvillim, me rreth 3 milion euro për Maqedoninë në nivel vjetor;
- 357.** Norvegjia paralajmëroi rritjen e mjeteve zhvillimore për Republikën e Maqedonisë për vitin 2018, kurse në periudhën vijuese pritet nënshkrimi i Memorandumit për bashkëpunim në projektendërmjet dy shteteve;
- 358.** Agjencia Franceze për Bashkëpunim Zhvillimor do të kërkojë mandat nga Qeveria e Francës për vendosjen e bashkëpunimit zhvillimor me Republikën e Maqedonisë;

- 359.** Vazhdimisht avancohet bashkëpunimi zhvillimor me të gjithë donatorët aktiv në Republikën e Maqedonisë;
- 360.** Raporti i Komisionit tregoi progres të lartë të Republikës së Maqedonisë në shumë fusha, sidomos kur vlerësimet krahasohen me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor;
- 361.** Maqedonia është në vendin e parë sipas progresit të realizuar ndërmjet vendeve të rajonit. Kjo paraqet valorizimin më të madh të arritjes së implementimit të Planit 3-6-9;
- 362.** Raporti i KE-së konstatoi se Maqedonia ju paraprinë vendeve të Ballkanit Perëndimor edhe nga aspekti i gatishmërisë ose harmonizimit të vendit me Bashkimin Evropian edhe sipas kriterëve ekonomike;
- 363.** Republika e Maqedonisë në maj të vitit 2018 u bë anëtare e plotë e Grupit të Vendeve të Adriatikut dhe Jonit
- 364.** SÇE mori rolin e koordinimit të procesit për implementimin e gjashtë nismave që rezultuan nga aneksi i Strategjisë së Komisionit Evropian për zgjerim me vendet nga Ballkani Perëndimor deri në vitin 2025;
- 365.** U formua grupi joformal miqësor i Maqedonisë i quajtur "Ohri" me përbërje: Lordi Xhorxh Robertson, ish sekretar i përgjithshëm i NATO-s, Rosen Plevneliev, ish president i Bullgarisë, Javier Solana, ish sekretar i përgjithshëm i NATO-s dhe përfaqësues i politikës së sigurisë në BE, Karl Bildt, ish kryeministër i Suedisë, Lordi Kristofer Gaidit, ambasadori Robert Gelbard nga ShBA, Alen Le Roa nga Franca dhe Volfgan Ishinger nga Gjermania, Dejmon Uillson nga Këshilli Atlantik dhe Zoran Çiçak, i cili jep përkrahje që me sukses të përfundojë procesi i integritetit të Republikës së Maqedonisë në NATO dhe BE.

NJË VIT  **NDRYSHIME**

MAQEDONIA PËR TË GJITHË

www.vlada.mk/1godinapromeni

